



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3125/ Prot.
-/4

Tiranë, më 20.11 2023

V E N D I M

Nr. 77 datë 20.11 2023

“PËR
RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER SHKENCOR NË
“AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI” NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË
FIZIKE DHE REKREACIONIT”

Në zbatim të nenit 3, pika 2 gërma b, nenit 49, pika d), nenit 81 të ligjit nr.80/2015 ” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr.57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të vecantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, VKM nr 825 datë 24.12.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 109 datë 15.2.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, të ndryshuar ”, të Udhëzimit të MAS nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë” i ndryshuar, nenit 43 të Statutit të UST-së, nenit 24 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Rektoratit nr. 116. Datë 03.11.2023, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.126 datë 14.11.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.11.2023,

V E N D O S I:

1. Të riorganizojë programin e studimit Master Shkencor në “ Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, sa i përket përmbajtjes së këtij programi.
2. Miratimin e pagesës sipas faturës përkatëse.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR ÇOBANI